



Komuna e Suharekës

DRAFT
PLANI I VEPRIMIT KOMUNAL PËR STREHIM FAMILJAR
PËR KOMUNËN E SUHAREKËS
2025-2027

Suharekë 2025

Përmbledhja	
Përmbledhje ekzekutive	2
Baza ligjore dhe nënligjore që e rregullon fushën e strehimit familjar	4
Korniza e akteve ligjore	5
Instrumentet ndërkombëtare.....	6
Konteksti lokal lidhur me formën e mbrojtjes – strehimit familjar	6
Konteksti specifik dhe kapacitetet e Drejtorisë Komunale për shëndetësi dhe përkujdesje sociale dhe Qendrës për Punë Sociale	8
Metodologjia e hartimit të planit të veprimit lokal.....	8
Objektivat e Planit Komunal të veprimit për Strehim Familjar në Komunën e Suharekës (2025-2027)	8
Matrica.....	11
<i>Monitorimi</i>	18
<i>Kornizë për monitorimin e procesit të zbatimit të planit të veprimit për strehimin familjar</i>	19

Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Suharekës është ndër komunat e Republikës së Kosovës, që i përket komunave më të vogla dhe sipas regjistrimit të fundit ka 45,713 banorë. Si komunë njihet si një ndër komunat që ka marrë iniciativa dhe veprime për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve e posaçërisht të strehimit familjar, përfshirë këtu të gjitha fazat që rregullojnë strehimin familjar dhe atë në farefis. Për të përmbushur detyrimet ligjore dhe për të siguruar funksionimin e duhur të këtij shërbimi, është hartuar një plan i veprimit që synon informimin, identifikimin, rekrutimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të familjeve strehuese dhe akterëve që ofrojnë këtë shërbim, duke u mbështetur në një qasje të strukturuar dhe të planifikuar. Ky dokument ka për qëllim promovimin dhe avancimin e strehimit familjar si një formë mbrojtjeje sociale dhe juridike, si brenda, ashtu edhe jashtë familjes biologjike.

Plani i Veprimit për Strehimin Familjar është një udhëzues strategjik që përfshin institucionet lokale, si Drejtoritë komunale, me udhëheqjen nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Qendra për Punë Sociale dhe partnerë të tjerë, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe komunitetin. Këto institucione bashkëpunojnë për të zbatuar masa që garantojnë mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për kujdesin e tyre.

Dokumenti përmban element të qartë, si qëllimin, objektivat, aktivitete dhe matrica të veprimeve konkrete, të cilat do të zbatohen nga institucionet komunale dhe partnerët e specializuar në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe strehimit familjar. Gjithashtu, ky plan përfshin angazhimin e akterëve në nivelet lokale dhe qendrore për promovimin e strehimit familjar, ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e tij dhe rritjen e vetëdijes mbi nevojën për përkujdesje të përkohshme për fëmijët pa kujdes prindëror.

Qëllimi kryesor i planit është zhvillimi dhe avancimi i mëtejshëm i shërbimit të strehimit familjar në Komunën e Suharekës. Përmes tij synohet rritja e numrit të familjeve strehuese në Kosovë dhe siguri i kujdesit për fëmijët pa përkujdesje prindërore. Hartimi i planit është bërë në përputhje me ligjet përkatëse, përfshirë Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligjin për Familjen, si dhe aktet nënligjore dhe strategjitë e organizatave si SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës.

Në thelb, Plani i Veprimit për Strehimin Familjar është një strategji gjithëpërfshirëse që synon përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mirëqenies për fëmijët pa kujdes prindëror. Ai adreson sfidat me të cilat përballen fëmijët në sistemin e strehimit familjar, duke krijuar një mjedis të sigurt, mbështetës dhe edukues për zhvillimin e tyre.

Komponentët kryesor të planit të veprimit të strehimit familjar përfshinë një sërë elementesh nëpërmjet së cilëve synohet:

- Promovimi dhe informimi i strehimit familjar, përmes platformave të ndryshme të komunikimit, përfshirë këtu edhe web-faqja e komunës, burime të tjera të komunikimit, fushata sensibilizuese dhe po ashtu përmes punës së përditshme të QPS-ve dhe takimeve me përfaqësues të grupeve të ndryshme të komunitetit.
- Të ngritët vetëdijësimi dhe informimi i opinionit për formën e mbrojtjes juridike dhe sociale për strehim familjar.
- Identifikimi dhe referimi, për strehim familjar bëhet në QPS, përmes bashkëpunimit ndër -sektorial dhe akterëve të tjerë relevant.
- Trajnimi dhe përzgjedhja e familjeve strehuese, do të bëhet në bashkëpunim me organizatat e licencuara për ofrimin e shërbimeve në ngritjen e kapaciteteve të kujdesit prindëror për plotësimin e nevojave të fëmijëve drejt zhvillimit të tyre.
- Sigurimin dhe lehtësimin për qasjen në shërbime mbështetëse përmes burimeve komunale dhe të tjera alternative për mbështetjen e familjeve strehuese.
- Mbështetje për përmirësimin e mundësive arsimore për fëmijët e strehuar, përkrahje për përfshirje në institucionet arsimore, përmes ofrimit të mbështetjes pedagogjike-arsimore, sipas nevojave.
- Mbështetje për përmirësimin e qasjes në shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë kontrollet e rregullta për të mbështetur mirëqenien e fëmijëve.
- Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet sektorëve: ofruesve të kujdesit të strehimit familjar, shkollave dhe palëve të tjera për të siguruar mirëqenien dhe një qasje të koordinuar dhe tërësore fëmijëve në proces të strehimit familjar.
- Përkujdesja ndaj familjeve strehuese ekzistuese dhe në farefis do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe dinamik, i përcjellur me vlerësim që do të ndihmojë të kuptojmë më mirë nevojat specifike, kapacitetet që kanë dhe sfidat me të cilat përballen.
- Në bashkëpunim me partnerët, do të avokohet për njohjen e profesionit të prindërve strehues si një shtyllë e rëndësishme e planit të veprimit. Njohja e profesionit të prindërve strehues do të rrisë vlerësimin dhe mbështetjen për punën e tyre të paçmuar, si dhe do të ndihmojë në krijimin e një sistemi më të qëndrueshëm dhe profesional për kujdesin ndaj fëmijëve në nevojë. Kjo gjithashtu mund të çojë në standardizimin e trajnimeve dhe

kualifikimeve për prindërit strehues, duke siguruar një kujdes sa më cilësor për fëmijët.

- Mbledhja dhe monitorimi i të dhënave për të përcjellë mirëqenien dhe përparimin e fëmijëve pa kujdes prindëror, duke mundësuar monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të efektivitetit të planit të veprimit.

Duke zbatuar këto objektiva, elemente, aktivitete, plani i veprimit për strehim familjar synon të përmirësojë cilësinë e përgjithshme të kujdesit për fëmijët në strehim familjar dhe atë në farefis, të rrisë mirëqenien e tyre dhe të rrisë shanset e tyre për të gjetur një familje dhe shtëpi të qëndrueshme dhe të përhershme.

Baza ligjore dhe nënligjore që e rregullon fushën e strehimit familjar

Aktet ligjore në Kosovë ofron një rregullim gjithëpërfshirës për strehimin familjar për fëmijët pa kujdes prindëror. Ligjet kryesore që përfshijnë këtë rregullim janë Ligji i Familjes nr. 2004/32¹ (2006), Ligji për shërbime sociale dhe familjare nr. 08/L-255² (2024) Udhëzimi administrativ për Strehim Familjar dhe Adoptim. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës³.

Legjislacioni rregullon aspektet e mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë ata pa kujdes prindëror, definojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve lokale dhe qendrore, sikurse edhe akterëve tjerë në zbatimin e masave ligjore të strehimit familjar të fëmijëve pa kujdes prindëror. Ne Ligjin e Shërbimeve sociale ne nenin 19 paragrafin 3.1 përkufizohet strehimi familjar citojmë: “strehimi familjar brenda apo jashtë familjes biologjike ku fëmijës ose të rriturit i sigurohet strehim dhe kujdes në mjedis familjar. Shërbimet e banimit përfshijnë pritjen, banimin, ushqimin, veshmbathjen, higjienën, kujdesin në dhomë, kujdesin për shëndetin, kujdestarinë, edukimin, aktivitetet e punës, rehabilitimin psiko-social dhe kohën e lirë” po ashtu ne nenin 22 strehimi familjar precizohet citojmë: neni 22 Strehimi familjar paragrafët :

1. Strehimi familjar është formë e mbrojtjes dhe ofrimit të shërbimit social jashtë familjes biologjike dhe tek të afërmit me të cilën fëmijës apo personit të rritur i sigurohet strehimi dhe përkujdesja para së gjithash në rrethin familjar në pajtim me ligjin.

2. Strehimi për fëmijë dhe të rinj përfshinë edhe përgatitjen për kthimin tek prindërit, rregullim tjetër të përhershëm jetësor dhe përgatitjen për jetë të pavarur.

Ne Ligjin për Vetëqeverisje lokale ne neni 17 pika k, shërbimet sociale janë kompetence vetanake e Komunës, përfshirë edhe strehimin familjar. Andaj, Komuna

¹ Ligji për shërbime sociale dhe familjare 08/ L – 255 Gazeta Zyrtare <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85111> ¹Ligji i Familjes i Kosovës – Gazeta Zyrtare <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>

³Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

duhet te marre te gjitha masat e nevojshme për të fuqizuar dhe ofruar shërbimin për fëmijët pa kujdes prindëror.

Komuna ka një rol kyç në zbatimin e shërbimit të strehimit familjar dhe atij në farefis, duke mbajtur përgjegjësi dhe obligime ligjore për të siguruar që ky shërbim të funksionojë në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme. Përmes Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS), komuna është përgjegjëse për identifikimin e fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje, përzgjedhjen e familjeve strehuese, si dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të mirëqenies së fëmijëve të vendosur në këto familje.

Një nga detyrat kryesore të komunës është sigurimi i mbështetjes financiare për familjet strehuese, duke respektuar kriteret e përcaktuara në Udhëzimet Administrative. Komuna duhet të garantojë një proces transparent dhe të drejtë në identifikimin dhe përzgjedhjen e familjeve strehuese, si dhe të krijojë mekanizma për monitorimin dhe mbështetjen e tyre, si në rastin e komunës së Suharekës, ku komuna e mbështet familjen strehuese me nga 150 Euro, në baza mujore, për çdo fëmijë të vendosur në familje strehuese. Për më tepër, komuna ka për obligim të organizojë fushata ndërgjegjësuere për të informuar komunitetin lokal mbi rëndësinë e strehimit familjar dhe për të nxitur pjesëmarrjen e familjeve të reja.

Komuna gjithashtu duhet të bashkëpunojë me nivelin qendror dhe akterët e tjerë, përfshirë OJQ-të dhe organizatat komunitare, për të ndërtuar kapacitete lokale dhe për të siguruar që punëtorët socialë të jenë të trajnuar dhe të pajisur me burimet e nevojshme për të menaxhuar rastet e fëmijëve dhe familjeve strehuese. Në zbatim të këtyre përgjegjësiave, komuna duhet të përputhet me ligjet në fuqi, si Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Ligji për Familjen, duke harmonizuar veprimet e saj me politikat kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

Në tërësi, obligimet e komunës lidhen me krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme mbështetëse që garanton sigurinë, mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, duke ndihmuar familjet strehuese të plotësojnë këtë mision të rëndësishëm social.

Çështja e strehimit familjar dhe përkujdesjes së fëmijëve pa kujdes prindëror është akoma sfidë për shoqërinë Kosovare, dhe për institucionet përkatëse.

Korniza e akteve ligjore

Legjislacioni në fuqi që përcaktojnë dhe rregullojnë fushën, por dhe përgjegjësitë e detyrimet e institucioneve lokale e qendrore në ofrimin e shërbimeve dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nevojë dhe pa kujdes prindëror

- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës
- Ligji i Familjes
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare
- Ligji për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës

- Ligji për Shëndetësi
- Ligji i Punës
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale
- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal

Aktet nën ligjore

- Udhëzimet administrative përkatëse për strehimin familjar dhe adoptimin.
- Standardet minimale për shërbime sociale

Instrumentet ndërkombëtare

- Konventa për të Drejtat e Fëmijës
- Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në lidhje me Adoptimin Ndërkombëtar
- Konventa Evropiane për Adoptimin e Fëmijës (e Këshillit të Evropës)
- Udhëzuesi i Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ
- Korniza Evropiane Vullnetare e Cilësisë për Shërbimet Sociale

Konteksti lokal lidhur me formën e mbrojtjes – strehimit familjar

Komuna e Suharekës ka pasur vazhdimisht nevoja dhe kërkesa për strehimin familjar si formë mbrojtjeje për fëmijët. Aktualisht në komunë janë 11 fëmijë të vendosur në strehim familjar në faqet dhe 1 në familje strehuese. Pavarësisht përpjekjeve dhe adresimeve të deritanishme, komuna ka ende nevojë për zhvillimin dhe avancimin e formave të mbrojtjes së fëmijëve. Pozicioni gjeografik i Suharekës, natyra e bukur, bizneset e zhvilluara dhe të suksesshme lokale, disa prej tyre të njohur edhe në nivel shteti dhe rajoni, krijojnë një dinamikë specifike që përveç se kërkesën për mekanizma më të strukturuar dhe të qëndrueshëm për mbrojtjen e fëmijëve, mundëson edhe mbështetjen dhe zhvillimin e mirëfilltë dhe të qëndrueshëm të strehimit familjar në këtë komunë.

Projeksionet për ekonominë dhe punësimin në komunë tregojnë një tendencë stabile, e cila nënkupton një rritje më të stabile ekonomike, sesa në komunat tjera në Kosovë, megjithëse sfida në vete mbetet migrimi dhe sfida e fuqisë punëtore. Andaj, edhe pse komuna përballlet me limitet buxhetore dhe të kapaciteteve njerëzore në nivel institucional dhe kjo shton presionin mbi shërbimet sociale, bizneset lokale shihen si një nga mundësitë për mbështetjen afatgjatë të fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdesje prindërore dhe kjo perceptohet si një vlerë e shtuar e kësaj komune. Varfëria dhe problemet sociale janë në rritje, sikurse në gjithë Kosovën, ndërsa nevojat për ndërhyrje dhe zgjidhje mbeten të vazhdueshme. Zhvillimet ekonomiko-sociale kanë rënduar edhe më tej situatën, duke shkaktuar një rritje të ndjeshme të kërkesave për shërbime publike, përfshirë shërbimet sociale. Si pasojë, Qendra për Punë Sociale (QPS) përballlet me mbingarkesë, ndërsa nevojat për mbështetje kanë shënuar rritje në të gjitha kategoritë e fëmijëve dhe familjeve.

Pavarësisht përpjekjeve të shumta, Komuna e Suharekës është duke u përballur edhe më tutje me sfidën për të përmbushë nevojën për identifikimin dhe angazhimin e familjeve të reja strehuese në këtë komunë. Ky boshllëk krijon një sfidë të vazhdueshme në ofrimin e mbrojtjes dhe përkujdesjes për fëmijët që kanë nevojë për strehim.

Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, është thelbësore të zhvillohen dhe forcohen kapacitetet lokale të Drejtorive Komunale, QPS-se, punëtorëve social, si dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve sociale nga radhët e OJQ-ve dhe profesionistëve të licencuar. Në veçanti, duhet të rritet ndërgjegjësimi publik për rëndësinë e strehimit familjar si një formë efektive e mbrojtjes për fëmijët në nevojë. Përmes programeve të specializuara dhe trajnimeve, mund të arrihet një përmirësim në cilësinë e këtyre shërbimeve, duke garantuar mbështetje më të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet prekura.

Ndërkaq, mes tjerash, aktualisht Komuna e Suharekës ka arritur që:

- Të nënshkruajë marrëveshje me SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës për strehimin familjar, për 3 familje strehuese në këtë komunë, me 2 fëmijë të vendosur në strehim familjar (apo OFAP ose organizata të tjera nëse ka marrëveshje të tilla)
- Të ofroj shërbime për fëmijë, nga të cilët, aktualisht janë 2 familje strehuese, në të cilat janë të vendosur 2 fëmijë dhe 11 fëmijë nën përkujdesje në familje strehuese në faqes;
- Të trajnojë 3-5 zyrtarë të shërbimeve sociale në trajnimet me programin për prindër strehues dhe adoptues-MiniPride.

Qendra për Punë Sociale (QPS) në Suharekë përballet me një sërë sfidash që e bëjnë të vështirë ofrimin e mbështetjes së nevojshme për familjet strehuese. Një nga sfidat kryesore është pamjaftueshmëria e mbështetjes financiare të ofruar nga shteti për këto familje, të cilës komuna i është përgjigjur me një shtesë prej 150 Euro për muaj, për çdo fëmijë, gjë që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimit të strehimit familjar, por mund të konstatojmë se QPS vuan nga mungesa e stafit dhe e kohës së mjaftueshme për t'u dedikuar mbështetjes së vazhdueshme për familjet dhe fëmijët në përkujdesje.

Një tjetër sfidë është identifikimi dhe përzgjedhja e familjeve të reja strehuese, proces i cili kërkon resurse dhe përkushtim të vazhdueshëm. Vështirësitë për të gjetur familje të gatshme dhe të përshtatshme për të strehuar fëmijë janë shtuar nga mungesa e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe promovuese të këtij shërbimi në komunitet.

Për të adresuar këto sfida, QPS Suharekë ka theksuar nevojën për disa masa kyçe: një vlerësim më sistematik të nevojave të familjeve aktuale dhe potenciale për strehim, krijimin e kontakteve të qëndrueshme me familje që plotësojnë kushtet për

strehim, si dhe zhvillimin e masave specifike që tërheqin dhe bindin familjet e reja të marrin pjesë në këtë formë mbrojtjeje. Po ashtu, është jetike organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse dhe promovuese, po ashtu të mbështetura edhe nga OJQ-të dhe organizatat dhe bizneset, si dhe takimet në terren me qytetarët dhe përdorimin e formave të tjera komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin dhe interesimin për strehimin familjar.

Konteksti specifik dhe kapacitetet e Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenies sociale dhe Qendrës për Punë Sociale

Numri i madh i kërkesave për shërbime sociale kërkon edhe resurse profesionale të mjaftueshme. Aktualisht Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Qendra për Punë Sociale, përballen e me sfidën e mungesës së stafit dhe trajnimeve profesionale që do të mbështesnin stafin e QPS-së në çështje specifike dhe ndarjen e detyrave sipas tyre, sipas specifikave të rasteve që ata menaxhojnë. Në momentin e zhvillimit të këtij plani të veprimit stafi profesional i angazhuar në QPS është 5 zyrtarë të shërbimeve sociale profesionale. Përderisa në DSHMS, aktualisht janë të angazhuar Drejtori i DSHMS-së dhe Udhëheqësi i Sektorit të Shëndetësisë.

Metodologjia e hartimit të planit të veprimit lokal

Fillimisht është realizuar një analizë paraprake e gjendjes dhe kontekstit lokal në Komunën e Suharekës, me fokus specifik në sferën e mbrojtjes së fëmijëve dhe ofrimin e shërbimit të strehimit familjar për fëmijët pa kujdes prindëror.

Hapat për hartimin dhe finalizimin e planit:

- Rishikimi dhe konsultimi i legjislacionit primar dhe sekondar
- Takimet konsultuese dhe informuese me përfaqësuesit e institucioneve lokale në Komunën e Suharekës.
- Përcaktimi i grupit punues.
- Punëtorja 2 ditore për përcaktimin e qëllimit, objektivave specifike dhe hartimi dhe përpunimi i draftit të planit të veprimit
- Komentet dhe sugjerimet finale nga anëtarët e grupit punues dhe
- Hartimi dhe finalizimi i planit
- Punëtorja e validimit të planit

Objektivat e Planit Komunal të veprimit për Strehim Familjar në Komunën e Suharekës (2025-2027)

Rritja e numrit të familjeve strehuese në komunë

Komuna përmes kësaj objektive synon që të rris numrin e familjeve strehuese duke punuar në identifikimin dhe referimin e familjeve strehuese, për trajnime dhe mbështetje, me qëllim të ofrimit të strehimit familjar sa më cilësor. Kjo objektiv do të arrihet edhe përmes zhvillimit të fushatës, në bashkëpunim me QPS, organizatat jo-

qeveritare dhe bizneset lokale me qëllim të promovimit dhe avancimit të strehimit familjar.

Fuqizimi i familjeve strehuese ekzistuese dhe atyre në farefis

Komuna synon të përmirësojë kushtet e jetesës dhe të mbështesë familjet strehuese ekzistuese dhe ato në farefis deri në fund të vitit 2027. Në këtë vazhde komuna synon të vazhdojë edhe përkrahjen financiare për familjet strehuese, me nga 150 Euro në muaj për çdo fëmijë dhe familje, gjatë kohës kur ata kanë një fëmijë në përkujdesje. Në këtë kuadër, familjet do të përfitojnë nga shërbime psiko-sociale dhe supervizi me të rregullta, si dhe do të ofrohen pako ushqimore, higjienike dhe materiale didaktike, për të siguruar një mbështetje gjithëpërfshirëse.

Përfshirja e Strehimit Familjar në fondin emergjent për shërbime sociale

Komuna do të mundësojë që fondin emergjent aktual për shërbimet sociale të jetë në dispozicion edhe për të adresuar nevojat e familjeve strehuese dhe fëmijëve në situata urgjente. Përfshirja e strehimit familjar në këtë fond do të garantojë mbështetje të shpejtë për mirëqenien e fëmijëve të strehuar dhe për stabilitetin e familjeve strehuese në situata të papritura.

Ofrimi i shërbimeve të integruara për fëmijë dhe të rinjë në Strehimin Familjar (psiko-sociale, shëndetësore, arsim)

Komuna e Suharekës do të fillojë procesin e lëshimit të një karte për identifikimin e familjeve strehuese dhe të rinjë që dalin nga kujdesi i strehimit familjar, në mënyrë që të lehtësojë dhe përkrahë proceset administrative, qasjen në shërbime të arsimit (shkolla dhe kopshte), si dhe shërbimet shëndetësore dhe shërbime të tjera, të nevojshme. Gjithashtu deri me 2026 dhe në vazhdim, komuna synon që të lidhë Marrëveshje bashkëpunimi me ndërmarrjet publike lokale dhe OJQ-të, bizneset lokale dhe OJQ -të dhe organizatat e tjera përkatëse për lirim të Familjeve Strehuese nga obligimet financiare dhe pagesa administrative për këto lloje shërbime.

Avokimi për njohjen e profesionit të Prindërve Strehues

Përmes këtij objekti, komuna synon që përmes aktiviteteve avokuese, në bashkëpunim të ngushtë edhe me Lidhjen e QPS-ve, deri në vitin 2027, të kontribuojë në iniciimin e procedurave për njohjen e Strehimit Familjar/Strehuesit Familjar, si profesion.

Ngritja e nivelit të vetëdijesimit për rëndësinë e strehimit familjar

Komuna synon që gjatë gjithë afatit kohor të implementimit të këtij plani të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësuë dhe promovuese për të rritur nivelin e vetëdijesimit publik për rëndësinë e strehimit familjar. Këto përfshijnë sesione informuese, materiale promovuese, paraqitje në media dhe përdorimin e platformave online për të nxitur

gatishmërinë e komunitetit për të kontribuar në këtë formë mbrojtjeje. Këto aktivitete gjithashtu do të përfshijnë edhe sesione informuese brenda dhe jashtë QPS, vizita dhe takime me përfaqësues të komunitetit si dhe zhvillimin e materialeve promovuese dhe informuese për Strehimin Familjar.

Zbatimi i mjeteve të mjaftueshme financiare për mbështetjen e Familjeve Strehuese në Suharekë

Komuna synon që të vazhdoj të sigurojë fonde të qëndrueshme për mbështetjen e familjeve strehuese, duke u siguruar që shuma prej 150 Euro për fëmijë të jetë pjesë e planifikimit financiar dhe buxhetit komunal edhe në vitet në vijim dhe po ashtu edhe përmes kontraktimit të partnerëve për shërbime sociale dhe identifikimit të donatorëve potencialë/bizneseve lokale, për të siguruar zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për këto familje.

Ngritja e kapaciteteve të akterëve relevantë

Duke bërë identifikimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve të profesionistëve të shërbimeve sociale, deri në vitin 2027, komuna do të zhvillojë trajnime dhe supervizime të rregullta për punëtorët social dhe aktorët kyç të përfshirë në shërbimet e strehimit familjar. Gjithashtu, do të synohet edhe organizimi i punëtorive shkëmbyese dhe i vizitave studimore, që do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve profesionale për menaxhimin e shërbimeve sociale në nivel lokal dhe kombëtar, me theks të veçantë strehimit familjar.

Matrica

Objektivi	Aktivitetet	Detyrat - Veprimet	Afati Kohor	Treguesi i matjes	Rezultati	Kosto financiare	Institucionet e përfshira
1. Rritja e numrit të familjeve strehuese dhe trajnimi i tyre për strehimin familjar	1. Identifikimi dhe referimi i familjeve strehuese tek institucionet përkatëse; 2. Përgatitja, rekrutimi, edukimi/trajnimi dhe informimi i familjeve strehuese potenciale, rreth strehimit familjar; 3. Zhvillimi i fushatës, në bashkëpunim me QPS, për promovimin e strehimit familjar	1. Zhvillimi i takimeve informative dhe vetëdijësuese me bashkësitë lokale, vizitat në terren(për nëna dhe fëmijë), këshillave të prindërve, bizneset lokale; 2. Hartimi i listës për Familjet Strehuese potenciale; 3. Ofrimi i trajnimeve të programit PRIDE 4. Ofrimi i informatave për SF.	2025-2027	- Numri i familjeve potenciale të identifikuar; Sigurimi/mbajtja e së paku 3 familjeve strehuese; -Brenda tri viteve, të gjitha familjet në farefis që kanë fëmijë në kujdes të kenë të përfunduar trajnimin për prindër Mini PRIDE; - Numri i takimeve me akterët relevant;	Rritja e numrit të familjeve strehuese aktive; Rritja e cilësisë së kujdesit të ofruar nga familjet strehuese të certifikuar; Rritja e numrit të familjeve strehuese potenciale; Rritja e vetëdijesimit dhe informimit; Rritja e numrit	600 Euro (SOS Fshatrat, trajnimi për prindër Mini-Pride) 300 Euro (SOS Fshatrat, materialet promovuese)	Këshillat lokal; Komuniteti fetar; Këshilli i prindërve; DSHMS; QPS; OJQ;SOS

				-Së paku 2 familje strehuese potenciale të identifikuara; Lista e përditësuar e familjeve të identifikuara dhe familjeve potenciale	të familjeve të trajnuara; Rritja e numri të familjeve strehuese potenciale		
2. Fuqizimi i familjeve strehuese ekzistuese dhe atyre në farefis	1. Shërbime psiko-sociale/supervizim falas për prindërit strehues sipas nevojës – së paku një herë në muaj; 2. Marrëveshje bashkëpunimi me OJQ dhe biznese lokale për përkrahjen Familjeve Strehuese	1. Realizimi i vizitave në familjet strehuese; 2. Ofrimi i pakove/produkteve ushqimore, higjienike, shëndetësore, materialeve didaktike; 3. Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, edukative dhe shëndetësore	2025-2027	-Së paku 1 vizitë në muaj në një familje strehuese -së paku 2 pako në vit për një familje strehuese -së paku 1 herë në muaj për familje ofrohen shërbime psiko-sociale dhe edukative e	Përmirësimi i kushteve të jetesës së familjeve strehuese ekzistuese dhe atyre në farefis dhe ofrimi i e lehtësirave dhe qasje në shërbime; Përmirësimi i kushteve dhe plotësimi i nevojave të	600€ (shërbimet shëndetësore mbulohet nga SOS); 900€ (supervizion mbulohet nga SOSFshatrat)	Komuna; DSHMS; QPS; OJQ;HANDIKOS,OFAP, SOS Fshatrat

	përmes pakove të ndryshme;	nëpërmjet ofruesve të shërbimeve sociale;		shëndetësore - Transferi i mjeteve tek fëmijët përfitues, 1 herë në muaj	fëmijëve në strehim familjar, po ashtu në farefis;		
3. Përfshirja e Strehimit Familjar në fondin emergjent për shërbime sociale	1. Vlerësimi i nevojave të nevojave nga QPS për mbështetjen e FS, në raste emergjente	1. Përfshirja e kësaj linje në buxhetin e vitit përkatës komunal; 2. Aprovimi i raportit të shpenzimeve nga komisioni përkatës, për faturat me aprovim	2025-2027	-Raporti për shfrytëzimin e fondit, fatura dhe pagesa	Fondi emergjenti disponueshëm edhe për nevojat e familjeve strehuese	3000€	DSHMS; QPS
4. Ofrimi i shërbimeve të integruara për fëmijë dhe të rinjtë në Strehim Familjar(psiko-sociale, shëndetësore, arsim, sport, kulturë,etj)	1. Kartë identifikimi për familjet strehuese dhe të rinjtë që dalin nga kujdesi i Strehimit Familjar 2. Marrëveshje bashkëpunimi	1. Kërkesa për shtypjen e kartelave të identifikimit për Familjeve Strehuese dhe të rinjtë që dalin nga kujdesi; 2. Pajimi i familjeve strehuese me kartelë;	2025-2027	-qasja e shpejtë në shërbimet e nevojshme për Familjeve Strehuese; -miratimi/hyrja në fuqi e vendimit për lirim nga	Qasje e shpejtë dhe e barabartë në shërbime për familjet strehuese	250€	DSHMS;QPS QMKF, KPF; Kuvendi Komunal; Kabineti i kryetarit Ndërmarrjet publike lokale, organizatat dhe OJQ-të

	me ndërmarrjet publike lokale dhe OJQ-të, organizatat përkatëse për lirim e Familjeve Strehuese nga obligimet financiare...	3. Informimi i akterëve relevant për rëndësinë dhe funksionin e kartelave; 4. Të iniciohet propozim vendimi për lirim nga taksat administrative komunale në Kuvendin Komunal?; 5. Lidhja e MoU me ndërmarrjet publike lokale dhe organizata dhe OJQ për lirim nga obligimet		taksat komunale -implementimi i MoU me NPL dhe organizatat dhe OJQ-të			
5.Avokimi për njohjen e profesionit të Prindërve Strehues	1. Zhvillimi i takimeve me akterë relevant (lidhja e QPS); 2. Nënshkrimi i kërkesës së përbashkët me partner (QPS)	1. Realizimi i takimeve koordinuese mes AKK dhe LQPS; 2. Pjesëmarrja aktive në takimet me komisionin parlamentar	2025-2027	-dorëzimi i kërkesës së përbashkët tek akterët relevant -njohja e profesionit të	Njohja institucionale e profesionit të Prindërve Strehues	N/A	LQPS; QPS; AKK; IAP;KOMF

	për njohjen e profesionit të Prindërve Strehues për Asociacionin e Komunave, Institucioni i Avokatit të Popullit	përsëritësi dhe mirëqenie 3. Takime me ministrinë e linjës; 4. Pjesëmarrja në përpilim dhe aprovimi i kërkesës së përbashkët		familjeve strehuese			
6. Ngritja e nivelit të vetëdijesimit për promovimin e strehimit familjar	1. Sesione informuese brenda dhe jashtë QPS, në nivel komunal; 2. Vizita dhe takime me përfaqësues të komunitetit 3. Zhvillimi i materialeve promovuese dhe informuese për SF 4. Paraqitja në media (ditë të	1. Realizimi i së paku 2 sesioneve në vit (në shtand, diskutime publike, ligjëratë në shkollë, këshilli i prindërve); 2. Dizajnimi dhe shtypja, shpërndarja e broshurave dhe materialeve të tjera promovuese gjatë aktiviteteve të ndryshme në	2025-2027	-Rritja e numrit të Familjeve Strehuese; -pjesëmarrja aktive e qytetarëve në diskutime, shtande, aktivitete vetëdijesuese, dëgjime publike, për SF	Rritja e kërkesave për të u bërë familje strehuese dhe rritja e gatishmërisë për të kontribuar në mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve në nevojë; Sigurimi i mbështetjes për SF	1200€	DSHMS; QPS; DKA; Këshilli i prindërve; Zyra për informim; SOS Fshatrat, OFAP

	caktuara dhe rregullisht); 5. Sesione informative dhe vetëdijësuese në shkolla për të rinjtë rreth strehimit familjar(këshillat e nxënësve dhe të prindërve)	komunë; 3. Pjesëmarrja në intervista në mediat lokale; 4. Zhvillimi i përmbajtjeve informuese në platformat online të komunës për strehim familjar (zyrtarët për informim)					
6. Zbatimi i mjeteve tëzotuar financiare përmbështetjen e Familjeve Strehuesen eSuharekë	1. Subvencionimi i familjeve strehuese nga komuna, në baza mujore; 2. Ofrimi i qasjes në shërbime shëndetësore; 3. Kontraktimi i partnerëve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për familjet;strehu	1. Takimi me Komitetin për Politikë Financa dhe 2. Zbatimi i vendimit për subvencionim 3. Identifikimi i donatoreve potencial dhe përpilimi i listës së tyre(bizneseve lokale); 4. Zhvillimi i	2025-2027	-vendimi për subvencionim -implementimi i projekteve -ngritja e numrit të donatoreve -numri i marrëveshjeve të nënshkruara me donatorë/bizn	Përmirësimi i shërbimeve për Familjet Strehuese, përmes mbështetjes financiare të qëndrueshme, me qëllim të përmirësimit të strehimit familjar	16.200 Euro(page sat mujore për familjet strehuese për 3 vite)	DSHMS;QPS Drejtoria e Financave; OJQ-të

	ese 4. Identifikimi i donatorëve potencial për përkrahjen e familjeve strehuese 5. Mbështetje financiare mujore për fëmijët në strehim familjar, në shumë prej 150€/muaj për fëmijë	takimeve me qëllim të sigurimit të fondeve nga donatorët potencial (bizneseve lokale) 5. Ekzekutimi i pagesave në baza mujore në shumë prej 150€/muaj, për fëmijë		ese lokale			
8.Ngritja e kapaciteteve profesionale të profesionistëve dhe akterëve relevant	1. Identifikimi i nevojave për ngritje të kapaciteteve profesionale të profesionistëve; 2. Zhvillimi i kurrikulave dhe zbatimi i trajnimeve; 3. Shkëmbimi i	1. Përgatitje e dokumentit për nevojat e profesionistëve; 2. Angazhimi i një eksperti ose grupi të ekspertëve; 3. Organizimi i vizitave studimore për shkëmbimin e	2025-2027	-së paku 2 trajnime/punëtori për ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve dhe akterëve të tjerë, për SF-realizimi i së paku 6 sesioneve në	Rritja e kapaciteteve për menaxhimin e shërbimeve sociale në nivel lokal dhe kombëtar	600€ zhvillimi i punëtorive (pritet të mbulohet edhe nga partnerët)	DSHMS; OJQ-të; Donatorët

	përvojave të profesionistëve e me përvojë në strehim familjar me vende të tjera, në nivel regional dhe vendor; 4. Punëtori për ngritje të kapaciteteve të akterëve kyç (DSHMS,QPS, OJQ)	përvojave dhe praktikave të mira; 4. Organizimi i punëtorive për ngritje të kapaciteteve të akterëve kyç me përfshirje multi-sektoriale		vit për supervizion			
--	---	---	--	---------------------	--	--	--

Monitorimi

Plani Komunal i Veprimit për Strehim Familjar në Komunën e Suharekës (2025-2027) do të përfshijë një sistem efikas monitorimi dhe vlerësimi për të siguruar suksesin e tij. Monitorimi i rregullt i progresit dhe vlerësimi i ndikimit të masave të ndërmarra janë thelbësore për të përmirësuar vazhdimisht politikat dhe strategjitë.

Ndërtimi i një sistemi të tillë është prioritet, pasi do të përmirësojë komunikimin, do të sigurojë reagim të shpejtë ndaj nevojave të qytetarëve dhe do të mundësojë vlerësimin efektiv të stafit.

Kornizë për monitorimin e procesit të zbatimit të planit të veprimit për strehimin familjar

Objektivi	Aktiviteti	Indikatorët e monitorimit	Burimet	Afati kohor	Përgjegjësia	Rreziqet/ Komente
Zhvillimi dhe fuqizimi i strehimit familjar në komunën e Suharekës	Zbatimi i Planit komunal për strehim familjar	Plani për strehimin familjar është miratuar nga Kuvendi Komunal i Komunës së Suharekës dhe është duke u zbatuar	Vendimi, dokumenti i Planit të veprimit	2025	Drejtoria për Mirëqenie Sociale	Nevoja për mbështetje teknike
Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive për ngritjen e kapaciteteve të familjeve strehuese	Trajnimi i familjeve potenciale për strehim familjar	Lista e pjesëmarrësve, raportet e trajnimeve;		2025	DMS, partnerët OJQ	Mund të mungojë interesimi
Krijimi i një baze të dhënash për familjet pritëse	Baza e të dhënave funksionale dhe e përditësuar	Baza e të dhënave, raport mujor		2026	DMS, QPS	Mungesë e IT mbështetjes
Mbrojtja dhe përkrahja e fëmijëve në strehim familjar	Vendosja e fëmijëve që kanë nevojë për strehim familjar dhe mbështetja e fëmijëve në strehim familjar	Numri i rasteve të referuara dhe të vlerësuara; Vendimet e QPS, raportet mujore	Raportet e Qendrës për Punë Sociale	2026	QPS, Gjykata, DMS	Mungesa e referimeve nga terreni; Procedura të ngadalta gjyqësore

Sigurimi i mbështetjes për familjet strehuese-pritëse	Ofrimi i mbështetjes financiare mujore për familjet strehuese-pritëse	Numri i familjeve që marrin mbështetje financiare	Transferet bankare, vendimet komunale	Vazhdueshëm	DMS, Zyra e Financave	Varësi nga buxheti komunal
Sigurimi i mirëqenies së fëmijëve dhe familjeve strehuese	Monitorimi dhe mbikëqyrja e fëmijëve të vendosur në familje strehuese	Numri i vizitave dhe raporteve të monitorimit	Raporte monitorimi, regjistrat e QPS	Çdo 3 muaj dhe sipas nevojës	QPS, QKMF	Mund të ketë mungesë të stafit

Për të arritur këtë, do të ndërmerren hapat e mëposhtme:

1. **Themelimi i Grupit të Monitorimit:** Një grup i dedikuar do të krijohet për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Veprimit.
2. **Takime të Rregullta:** Grupi do të zhvillojë takime tremujore për të diskutuar progresin dhe sfidat.
3. **Përpilimi i Raporteve:** Do të përgatiten raporte të rregullta, duke paraqitur rezultatet e monitorimit, sfidat aktuale, propozimet për përmirësime dhe hapat e ardhshëm.